


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE QARKU VLORË



Qarku i Vlorës ka një sipërfaqe prej 2.706 km², kufiri detar 244 km. Ai përfshin rrethin e Delvinës, rrethin e Sarandës dhe rrethin e Vlorës. Në përbërje të tij janë 26 njësi administrative, përkatësisht: 7 Bashki dhe 19 Komuna. Qarku i Vlorës kufizohet në veri me Qarkun e Fierit, në lindje Qarkun e Gjirokastrës, në jug me Greqinë dhe në jugperëndim deri në perëndim me Detin Adriatik dhe Detin Jon gjatë bregdetit. Popullsia e Qarkut të Vlorës (2010) është 374,168 banorë¹ dhe dendësi 138.2 banor/km².

Vlora në lashtësi njihej me emrin Aulona.

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011





Gjurmët më të hershme i takojnë shek. VI p.e.s..

Ali Pashë Tepelena e pushtoi më 1812. Vlora ishte kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur. Më 28 nëntor 1912 Kuvendi Kombëtar shpalli këtu Pavarësinë në Sarajet e Vlorajve dhe formoi qeverinë me kryeministër Ismail Qemal Bej Vlorën.

Saranda, qyteti i dytë më i madh i Qarkut të Vlorës, është një nga joshjet më të mëdha turistike të Rivierës shqiptare. Ajo ndodhet vetëm 2 milje detare larg Korfuzit dhe pranë saj gjenden mbetjet e qytetit antik të Butrintit, i shpallur nga UNESCO-ja si Trashëgimi Botërore. Delvina është vetëm 16 km në verilindje të Sarandës. Pranë qytetit ndodhet një kështjellë mesjetare, kurse në jugperëndim të Delvinës gjenden gërmadhat e qytetit antik të Phenice-Finiqi i sotëm, i cili është deklaruar Park Arkeologjik më 2005.

Më shumë informacion rreth qarkut mund të gjeni në faqen: <http://www.qarkuvlore.gov.al>



Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Qarku i Vlorës në vitin 2010, ka 374,168¹ banorë dhe 99.973² familje në total. Nga numri total i familjeve në qark, 1373 *familje* (1.37%) janë familje të varfra dhe kanë fëmijë (grupmosha 0-18 vjeç). Fëmijët (0-18 vjeç) përbëjnë 25.4 % të popullsisë (94,952 fëmijë).

Në vitin 2010 në Qarku e Vlorës 1 në 38 fëmijë (2,459 fëmijë) të grupmoshës 0-18 vjeç jetonte në familje të cilat trajtoheshin me Ndihmë Ekonomike (NE).

Fëmijët rom janë përqëndruar kryesisht në Komunën e Novoselës, Shushicës dhe Bashkinë Delvinë. Një fenomen shumë i përhapur është ardhja e familjeve rom nga Korça dhe Elbasani çdo pranverë, të cilët stacionohen me familjet e tyre në rrugët e qytetit të Vlorës dhe Sarandës kryesisht dhe përdorin fëmijët e tyre për të lypur në rrugët e qytetit. Në të gjithë qarkun e Vlorës ka vetëm 3 qendra që ofrojnë shërbime për fëmijët jetim ose fëmijë që jetojnë në kushte ekstreme varfërie apo në mungesë të njërit prej prindërve. Këto institucione janë:

- Shtëpia e foshnjës në Vlorë;
- Qendra e zhvillimit të aftësisë së kufizuar në bashkinë Vlorë dhe
- Shtëpia e fëmijës Sarandë, - e cila shërben dhe si qendër ditore.

Në qarkun e Vlorës është vënë re një ndërgjegjësim në të gjitha komunat dhe bashkitë e qarkut për respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për fëmijë.

Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Vlorës

¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Bredhshme, Mars 2011

² Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

në vitin 2010, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.



Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Vlorë gjendet në:

Sheshi "4 Heronjtë", Këshilli i Qarkut Vlorë, Kati 3-të

Vlorë, Shqipëri

e-mail: observatori_vl@yahoo.com

URL: www.observator.org.al







Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Në qarkun e Vlorës është hartuar dhe miratuar "Strategjia Rajonale për të Drejtat e Fëmijëve" dhe "Plani i Veprimit 2011-2013".

	Delvinë	Sarandë	Vlorë
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor ¹	437	1309	6250
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar ²	1357	4641	18097
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e mesëm ³	288	1470	6766

Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Vlorës, veç zyrës së Observatorit, është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve" në Qark.







Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë", - janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.

1 Burimi: Drejtoria Arsimore Rajonale, - Vlorë (Tetor 2011)

2 Ibid;

3 Ibid;



Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç që jetojnë në familje të cilat mbështeten me NE

